

“REALIZ” Sh.p.k PUKE

RAPORT TEKNIK PER AKTIVITETIN Shfrytezim i mineralit te troktoliteve NE SIPERFAQEN E ZGJERUAR TE LEJES MINERARE Nr.1876 “FUSHE LAJE”, PUKE

Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”
Shtojca 1,Kodi eshte 19



Objekti: Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : Leja minerare nr 1876, objekti "Fushe Laje», Puke

INVESTITOR: SHOQËRIA “REALIZ” Shpk

Hartoi: Ing. Adhurim Çausi

Ekspert VNM/ Certificate Nr. 5129 Prot. Nr. Identifikues 426

Tirane, 2022

Hyrje

a. Qellimi i projektit te propozuar

b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti

ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit

d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike te shfrytezimit te troktoliteve me kariere, perfshire kapacitetin prodhues, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.

e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje,shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuesete aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja

f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar te funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit

g. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit

h. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje, energji)

i. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistueseperreth/prane zones te projektit

j. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

l.Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeveapo rezidencave etj.

m.Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

k. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar , ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

HYRJE

Shoqëria “ **REALIZ**” shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT **L71822022A** dhe administrator z. Andis NELI në fushën e aktivitetit Shfrytëzim të mineraleve të grupit të ndërtimit dhe metalor, ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit minerar për mineralin troktolit.

Subjekti “**REALIZ**”shpk; është një shoqëri vendase me eksperience modeste ne shfrytezimin dhe perpunimin e mineraleve te ndertimit e regjistruar ne vendin tonë në datën 22.06.2017, Gjate aktivitetit te saj ajo ka akumuluar një eksperiencë shume vjeçare në fushën e këkim-zbulim-shfrytëzimit dhe tregetimit te mineraleve ka mundësi financiare për realizimin e investimeve të parashikuara për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të mineralit te te ndertimit (*gure dekorative*) në objektin e kërkuar për marrjen e lejes mierare të shfrytëzimit punimeve minerare si dhe miratimit te kerkeses per zgjerim te siperfaqes.

Subjekti ka paraqitur kerkese te argumentuar per zgjerim te siperfaqes r prane Drejtorise Minerare te MEI sipas percaktimeve te VKM nr . Duke qene se, zhvillimi gjenetik i mineralizimit eshte jashte kufijeve te licensuar, pas kerkeses se bere nga ana e subjektit , prane MEI, eshte dhene ok nga kjo e fundit per zgjerim te siperfaqes

Kerkesa e paraqitur nga subjekti per rishikim dhe zgjerim te siperfaqes se lejes eshte pranuar nga MEI e cila nga ana e vete , me shkresen nr.61/1 Prot date 11.04.2022 “Njoftim per fillimin e procedurave per zgjerimin e lejes, e MIE, njofton subjektin “, AKBN dhe QKB fillimin e procedurave per zgjerim te siperfaqes se lejes

a. Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar nga shoqeria eshte shfrytezimi i mineralit te troktoliteve me kariere me punime siperfaqesore, objekti leja minerare nr.1876 objekti "Fushe Laje" rrethi Puke, per nxjerren e mineralit te troktolitit qe sherben si lende e pare ne industrine e ndertimit ne trajte blloqesh apo pllaka me dimensione te ndryshme.

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit.

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvellimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te aktivitetit dhe rehabilitimin e hapesires te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar

- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

Kjo zone ofron kushte lehtesuese per shfrytezimin e troktoliteveme kariere me punime siperfaqesore sepse eshte nje zone large qendrave te banuara, kun prek vepra te vecanta dhe nuk bene pjese ne ndonje zone te mbrojtur rruge per ne objekt jan pothuaj te hapura dhe me pake punime mund te fillohet nga aktivitetit. Nga pikpamja gjeografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytezim pjese e malit te Terbunit eshte terren kodrinor.

Kjo zone ofron kushte lehtesuese per shfrytezimin e troktoliteveme kariere me punime siperfaqesore sepse eshte nje zone large qendrave te banuara, kun prek vepra te vecanta dhe nuk bene pjeswe ne ndonje zone te mbrojtur rruge per ne objekt jan pothuaj te hapura dhe me pake punime mund te fillohet nga aktivitetit. Nga pikpamja gjeografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytezim eshte terren fushe ne lartesi malore me kuota mbi 1300 mbi nivelin e deit.

b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar, te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

Shoqeria ka patur lejes minerare nr. 1876 Gjate periudhes se deritanishme subjekti ka kryer investimet e nevojshme ne pajisje e makineri ngarkimi e transporti si dhe ka ndertuar impiant thyerje e fraksionimi prane objektit.

Subjekti ka paraqitur kerkese te argumentuar per zgjerim te siperfaqes prane Drejtorise Minerare te MEI sipas percaktimeve te VKM. Duke qene se, zhvillimi gjenetik i mineralizimit eshte jashte kufijeve te licensuar, pas kerkeses se bere nga ana e subjektit , prane MEI, eshte dhene ok nga kjo e fundit per zgjerim te siperfaqes

Kerkesa e paraqitur nga subjekti per rishikim dhe zgjerim te siperfaqes se lejes eshte pranuar nga MEI e cila nga ana e vete me shkres Nr 61/1, date 11.04.2022 , *“Njoftim per fillimin e procedurave per zgjerimin e lejes minerare nr. 1876 date 18.11.2019, e MIE, njofton subjektin” sh.p.k , AKBN dhe QKB fillimin e procedurave per zgjerim te siperfaqes se lejes*

Ne procesin e shfrytezimit te karrieres eshte punuar sipas projektit te miratuar nga MIE dhe institucionet vartese ne kohen e marrjs se lejes minerare.

Karriera eshte prashikuar te prodhoje deri 5000 m3 troktolite .

Per periudhen deri 2021 prodhimi i realizuar ka qene i ulet edhe per shkak te prezences se fenomenit e shkaterrrimit nga agjentet atmosferike. Ne kete kuader edhe projekti qe paraqitet ploteson kerkesat e ligjit minerar Shqiptar per zgjerim siperfaqeje mbas periudhes dhjet vjeçare.

Nëpërmjet projektit synohet të vijohet te shfrytëzohen troktolite, qe klasifikohen ne grupin mineralet dhe materialet e ndërtimit.

Shrytëzimi do të vijojë të bëhet me kariere të tipit të dyte, në përputhje me ligjin e sipërcituar.

Materiali i prodhuar nga ky aktivitet, përdoret kryesisht si lende e pare për prodhim plaka dhe blloqe të dimensioneve të ndryshme

Sterilet dhe lende të tjera të padobishme mund të përdoren në fusha të tjera të ndryshme si stabilizant në shtrim rrugësh etj. Deri tani ato kanë qenë të pa përfillshme

Për hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit të këtij vendburimi janë marre në konsideratë:

- Gjendja aktuale e karrierës mbas shfrytëzimit të saj në periudhën e tanishme (shih hartën gjeologjike me gjendje aktuale të karrierës)
- Pozicioni gjeografik dhe marrëdhëniet e tij me qendrat e banuara;
- Topografia dhe klima e zonës në të cilën ndodhet;
- Hidrologjia dhe hidrografia e zonës në të cilën vendoset;
- Gjendja e infrastrukurës së rajonit në përgjithësi dhe e zonës së objektit, në veçanti, mundësitë e përmirësimit të saj ;
- Materiali gjeologjik bazë lidhur me ndërtimin gjeologjik të rajonit dhe objektit, sasinë dhe cilësinë e rezervave gjeologjike dhe të shfrytëzueshme brenda kufijve të përcaktuar të sheshit të kërkuar ;
- Ndërtime dhe instalime teknologjike të tjera të domosdoshme për shfrytëzimin e objektit nga pikpamja minerare.

Teritori për të cilin kërkohet zgjerimi i lejs minerare, është studjuar me pare nga ana gjeologjike për vlershmerinë e lendës së pare dhe ka rezultuar se ajo i kënaq kërkesat për tu përdorur për prodhim material inerte.

Prodhimi vjetor në objekt është parashikuar të jetë 3000- 5000 m³/vit troktolite, për një periudhë e mbetur, me mundësi rritje prodhimi, në përputhje me kërkesat e tregut.

Nga ky aktivitet minerar nuk demtohen toka buke, pyje, kullota, ujra mbi dhe nëntokësore, vepra arti apo të tjera të mbrojtura me ligj.

Relievi i shpatit është i pandryshueshëm pasi nuk janë vërejtur fenomene të erozionit të dukshëm, që ndryshojnë relievin apo krijojnë probleme në kariere, në mjedisin rreth e qark etj. Pas përfundimit të shfrytëzimit ai do të jetë një ambient i gjelbëruar me brezare, shumë piktorisk (shkallët e karrierës do të mbillen me bimë dekorative).

Nga ky aktivitet minerar, krahas vetë subjektit privat përfitojnë:

- Shteti nëpërmjet vjeljes së taksave dhe tatimeve;
- Sigurimet shoqërore e shëndetsore nëpërmjet vjeljes së kontributeve përkatëse.
- Popullsia rreth e qark nëpërmjet punësimit të disa punonjësve;
- Tregtia nëpërmjet rritjes së shkëmbimeve tregtare

Behen disa përmirësime në infrastrukture që mbeten si pasuri pas përfundimit të

1.2 Vendndodhja e objektit

Objekti ndodhet në vendin e quajtur Fushe Laje në pllajen e Livadhit të Hamzit, në malin Tërbun të rrethit Pukë , rreth 5 km ne VL të qendrës së komunes Gjeggjan të rrethit Pukë dhe rreth 10.5 km nga rruga automobilistike Pukë Fushë-Arrësi.

Sheshi i licensuar ndodhet larg shtëpive të banimit dhe nuk është pronë individuale. Ai është pasqyruar në hartën topografike të Republikës së Shqipërisë në shkallën 1 : 25000, (ne planshetin me neomenklature K-34-76-B-b) dhe kufizohet nga pikat me koordinata si në tabelën e mëposhtme:

Koordinatat epikave kufizuese te lejes minerare Nr 1876

Koordinatat e lejes minerare nr.1876		
Nr.	Y	X
1	4411504	4645919
2	4411533	4646343
3	4411844	4646346
4	4411859	4645942
Siperfaqja = 0.138 km²		

Siperfaqja e zones se kerkuar = 0.138 km².

Tabela me koordinatat e zgjeruara:

Koordinatat e kerkuara per zgjerim		
Nr.	Y	X
1	4411504	4645919
2	4411496	4646708
3	4411851	4646693
4	4411859	4645942
Siperfaqja = 0.273 km²		

Siperfaqja e zones se zgjeruar= 0.273 km².

Kjo zone eshte e papyllezuar, pa objekte banimi e industriale dhe nuk gezon ndonje status te vecante. Objekti eshte i lidhur me rrugen ekzistuese nacionale. Zona nuk ka ndonje perdorim te vecante ,eshte shfrytezuar nga shoqeria per nxjerrjen e gurit gelqeror. Ne perfundim te aktivitetit kjo zone do te rehabilitohet dhe do ti kthehet funksionit te meparshem te saj dhe perdorimit nga banoret e zones per kullote. Ne objekt eshte kryer nje mori punimesh gjeologjike te kerkim-zbulimit te tipit kanale pastrime etj. Rezultatet e mara nga keto punime te kryer nga ish Instituti, “Gjeoalba” Ndermarrja Gjeologjike Puke viti 1994, Instituti Studimeve Projektmeve te Gjeologjise viti 1995, Sherbimi Gjeologjik Shqiptare Instituti Kerkimeve te Gjeologjise,Departamenti i Vendburimeve dhe Metalogjenise viti 1999 si dhe dokumentimet e

“REALIZ”, sh.p.k.

ndryshme, te kryera nga vete subjekti gjate kryerjes se punimeve te shfrytezimit ne zonen e objektit , kane sherbyre si baze per hartimin e pjeses grafike dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti .

Shfrytëzimi do të bëhet me punime sipërfaqesore , në përputhje me kërkesat e ligjit Nr 10304,date 15/07/2010“Per Sektorin Minerar ne Republiken e Shqiperise”, si dhe të të gjitha akteve nënligjore të dala në zberthim e për zbatim të tij.



“REALIZ”, sh.p.k.



Ortofoto e lejes ekzistuese

GeoPortal

Data e Printimit: 10.11.2010.

4410642.535
4647134.521

4412868.614
4647108.544




Legjenda

- Ndërtesat (Adresari)
- Ndërtesat (ZQRPP)
- Emërtime Gjeografike (ASIG)
- Zonimi (Zonat e Mbrojtura)
- Rendi 1 (Kufiri Tokësor)
- Parcelat
- Ndërtesat

4410626.036
4645720.467

4412852.115
4645694.497

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4
Projektimi: KRGJSH




Ortofoto e lejes minerare nr.1876

<https://geoportal.asig.gov.al>

Data e Printimit: 02.06.2022.

4409382.856
4648005.406

4418125.441
4647903.370




4409317.994
4642445.296


4418060.581
4642343.360

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

Sistemi koordinativ: Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4
Projektimi: KRGJSH



HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE E LEJES NR. 1876 TE KERKUARA PER ZGJERIM, FUSHE LOPE, PUKE
 shk 1: 26 000



“REALIZ”, sh.p.k.

Objekti është i rrethuar nga kodra dhe nuk do të ketë asnjë ndikim megjithatë në kariere do të punohet pa përdorimin e lendeve plasuese. Vendi që do të shfrytëzohet nuk është i lakmueshëm edhe për shfrytëzim për kullotjen e bagetive nga banorët e zonës.

Rrjedhimisht shfrytëzimi që kërkon të bëjë shoqëria nuk ndikon në zhvishmërinë e zonës dhe dëmtimet e bimesisë së lartë e cila nuk është e pranishme në sipërfaqe që do të shfrytëzohet.



c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administroren territorin ku propozohet projekti

Qendr administrative e rrethit eshte qyteti i pukes me rreth 2200 banore , ndersa vete zona minerare bene pjese ne njesine administrative qe eshte fshati Gjegjan (Puke) me rreth 400 banore. Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore, blegtorale nje pjese e vogel eshte e punesuar ne objekte te ndryshme minerare qe jane ne aktivitet ne kete zone apo ne aktivitete ne sherbim te turizmit apo tregti.

Nje pjese e mire e popullsisë punon ne emigracion dhe kryesisht ne Greqi. Popullsia e pergjitheshme e fshatrave te siperpermendur eshte rreth 1800 banore. Qendrat e banuara me te aferta jane fshati Gojan dhe qyteti i Fushe Arrezit etj,


Mund te themi qe popullsia e ketyre fshatrave 90% eshte autoktone. Kryerja e ketij aktiviteti do te ulte sado pak plagen e emigracionit dhe do te punesoheshin disa punonjes.



Puka, Sheshi kryesor i qytetit



Pamje e qytetit Puke



Njesia administrative Gjegjan Puke



Largesia e objektit nga fshati Gjegjan dhe Gojan eshte mbi 3 km.

Zona qe do te shfrytezohet ndodhet ne NJA Gjegjan, Bashkia Puke.

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë. Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare.

Pozicioni gjeografik dhe marrdheniet e objektit me qendrat e banuara, kryesisht me Gjegjan rreth 6 km larg dhe Fushe Arrez, qe ndodhet rreth 10.5 km m larg objektit



Foto nga fshati Gjegjan dhe ne sfond ana juglindore e malit te terbunit

ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit

Projekti nuk kërkon ndërtim të strukturave me themele

Që në fillim të aktivitetit të tij subjekti ka parashikuar vendosjen e një objekti sandwich me tre ndarje që do të shërbejë si zyrë, magazinë dhe ambient pushimi.

Perdorimi i këtyre objekteve të gatshme preferohet për zyrë dhe ambiente shërbimi sepse kushtojnë më pak se të ndërtosh objekte me themele dhe instalohen shumë lehtë. Janë të cmontueshme dhe mund të rivendosen në vende të tjera. Janë cilësore dhe komferte si për stinën e dimrit edhe në verë.

Perparesitë e përdorimit të paneleve sandwich

1- Lehtësisht të instalueshëm dhe të cmontueshëm, kanë një jetëgjatësi 15-20 vjet

2- Kanë lehtësi në transport dhe zhvendosje


3- Mund të riperdoren disa here dhe nuk demtojnë mjedisin

4- Të papershkueshme nga uji dhe zjarri, si dhe nga lagështia

5- Durojnë shpejtësi erë der në 110 km/h

6- Janë të izoluar nga zhurmat

7- Sizmikesht të qëndrueshme der në shkallë 7 richter



1- Paneli i catise

2- Lesh xhami me flete metalike alumini

3- Elemente lidhës të galvanizuar

4- Pjate celiku për tavanin

5- Tra horizontal në cati



6- Tra horizontal anesor

7- Tra persegjati

8- Dritare alumini

9- Tra horizontal fundor

- 10- Tra persegjati
- 11- Dera
- 12- Muri panel sandwich
- 13- Tra fundor persegjati
- 14- Dyshemeja
- 15- Pllake cimentoje
- 16- Tra horizontal fundor



d. Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfishire kapacitetet prodhuese/ perpunuese , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit

Studimi tekniko-ekonomik dhe projekti i shfrytezimit te objektit "*Fushe Laje*", Puke eshte hartuar mbi bazen e projektit te hartuar nga subjekti ne kohen e miratimit te kerkeses per zgjatjeafati.,me te cilin subjekti eshte pajisur me licensen nr 1876 dhe gjendjes aktuale te punimeve minerare si dhe miratimit te kerkeses per zgjerim te siperfaqes.

Subjekti ka paraqitur kerkese te argumentuar per zgjerim te siperfaqes r prane Drejtorise Minerare te MEI sipas percaktimeve te VKM nr . Duke qene se, zhvillimi gjenetik i mineralizimit eshte jashte kufijeve te licensuar, pas kerkeses se bere nga ana e subjektit , prane MEI, eshte dhen ok nga kjo e fundit per zgjerim te siperfaqes

Kerkesa e paraqitur nga subjekti per rishikim dhe zgjerim te siperfaqes se lejes eshte pranuar nga MEI e cila nga ana e vete , *me shkresen nr . 61/1 Prot date 11.04.2022 “Njoftim per fillimin e procedurave per zgjerimin e lejes, e MIE, njofton subjektin “, AKBN dhe QKB fillimin e procedurave per zgjerim te siperfaqes se lejes*

Të dhënat bazë gjeologjike sasiore dhe cilësore të objektit janë marrë nga studimet e kryera nga aktivitetit i deritanishem dhe te dhenave te vet subjektit nga aktiviteti i shfrytezimit ne objekt

Nisur nga kjo gje, subjekti “Realiz ” sh.p.k ndermerr hartimin e projekti te shfrytezimit per siperfaqen e zgjeruar te mesiperme

Studimi tekniko-ekonomik dhe projekti i shfrytezimit ne siperfaqen e zgjeruat te objektit , eshte hartuar mbi bazen e projektit te hartuar nga subjekti privat, per licensim, , gjendjes aktuale te punimeve si dhe miratimit te kerkeses per zgjerim te siperfaqes mbi argumentat qe subjekti ka paraqitur ne Ministri per krkim zgjerim siperfaqe.

Projekti tekniko ekonomik i shfrytëzimit të gurëve gëlqerorë në objektin “Fushe Laje, Puke, rrethi Puke Qarku Shkoder është kryer me porosi të shoqerise private “RELIZ”sh.p.k, nga studio "H&M MINING

Shoqeria ka patur lejes minerare nr. 1876 Gjate periudhes se deritanishme subjekti ka kryer investimet e nevojshme ne pajisje e makineri ngarkimi e transporti si dhe ka ndertuar impiant thyerje e fraksionimi prane objektit.

Ne procesin e shfrytezimit te karrieres eshte punuar sipas projektit te miratuar nga METE dhe institucionet vartese ne kohen e marrjs se lejes minerare.

Sikunder duket edhe nga fotot dhe planimetria me gjendjen e karrieres ne fund te vitit 2021, objekti paraqitet mire ne drejtim te parametrave te shfrytezimit

Karriera eshte prashikuar te prodhoje deri 5000 m3 troktolite .

Per periudhen deri 2021 prodhimi i realizuar ka qene i ulet edhe per shkak te prezences se fenomenit e shkaterrrimit tnga agjentet atmosferikeNe kete kuader edhe projekti qe paraqitet ploteson kerkesat e ligjit minerar Shqiptar per zgjerim siperfaqeje mbas periudhes dhjet vjeçare.

Nëpërmjet projektit synohet të vijohet te shfrytëzohen troktolite, qe klasifikohen ne grupin mineralet dhe materialet e ndërtimit.

Shrytëzimi do të vijojë të bëhet me kariere të tipit të dyte, në përputhje me ligjin e sipërcituar.

Materiali i prodhuar nga ky aktivitet, përdoret kryesisht si lende e pare për prodhim plaka dhe blloqe të dimensioneve të ndryshme

Sterilet dhe lende të tjera të padobishme mund të përdoren në fusha të tjera të ndryshme si stabilizant në shtrim rrugësh etj. Deri tani ato kanë qenë të pa përfillshme

Për hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit të këtij vendburimi janë marrë në konsideratë:

- Gjendja aktuale e karrierës mbas shfrytëzimit të saj në periudhën e tanishme (shih hartën gjeologjike me gjendje aktuale të karrierës)
- Pozicioni gjeografik dhe marrëdhëniet e tij me qendrat e banuara;
- Topografia dhe klima e zonës në të cilën ndodhet;
- Hidrologjia dhe hidrografia e zonës në të cilën vendoset;
- Gjendja e infrastrukurës së rajonit në përgjithësi dhe e zonës së objektit, në veçanti, mundësitë e përmirësimit të saj ;
- Materiali gjeologjik bazë lidhur me ndërtimin gjeologjik të rajonit dhe objektit, sasinë dhe cilësinë e rezervave gjeologjike dhe të shfrytëzueshme brenda kufijve të përcaktuar të sheshit të kërkuar ;
- Ndërtime dhe instalime teknologjike të tjera të domosdoshme për shfrytëzimin e objektit nga pikpamja minerare.

Teritori për të cilin kërkohet zgjerimi i lejs minerare, është studjuar me pare nga ana gjeologjike për vlershmerinë e lendës së pare dhe ka rezultuar se ajo i kënaq kërkesat për tu përdorur për prodhim material inerte.

Prodhimi vjetor në objekt është parashikuar të jetë 3000- 5000 m³/vit troktolite, për një periudhë e mbetur, me mundësi rritje prodhimi, në përputhje me kërkesat e tregut.

Nga ky aktivitet minerar nuk demtohen toka buke, pyje, kullota, ujra mbi dhe nëntokësore, vepra arti apo të tjera të mbrojtura me ligj.

Relievi i shpatit është i pandryshueshëm pasi nuk janë vërtur fenomene të erozionit të dukshëm, që ndryshojnë relievin apo krijojnë probleme në kariere, në mjedisin rreth e qark etj. Pas përfundimit të shfrytëzimit ai do të jetë një ambjent i gjelbëruar me brezare, shumë piktorisk (shkallët e karrierës do të mbillen me bimë dekorative).


Nga ky aktivitet minerar, krahas vetë subjektit privat përfitojnë:

- Shteti nëpërmjet vjeljes së taksave dhe tatimeve;
- Sigurimet shoqërore e shëndetsore nëpërmjet vjeljes së kontributeve përkatëse.
- Popullsia rreth e qark nëpërmjet punësimit të disa punonjësve;
- Tregtia nëpërmjet rritjes së shkëmbimeve tregtare

Behen disa përmirësime në infrastrukture që mbeten si pasuri pas përfundimit të

Ne ndertimin gjeologjik te zones te marre ne studim marrin pjese formacionet shkembore magmatike te zones se Mirdites, duke filluar nga vullkonogjeno –sedimentaret βT_2 - J_1 ne forme te dy brezave ne VP dhe JP te objektit me gjersi nga 80 deri 1600m dhe zgjatje veri-Jug deri 300-450m. Shkembinjat ultrabazike te perfaqesuar nga verilite plajiklazike σJ_2 te cilet perbejne nje mase te madhe te shkembinjave qe rrethojne traktolitet e objektit me kalim gradual ne gabro traktolite. Keto lloje shkembore zgjaten deri 1km dhe mbesin te hapur jashte planshete me gjersi nga 40 - 100m

“REALIZ”, sh.p.k.



Ndertimi gjeologjik i vendburimit.

Objekti perfaqesohet nga traktolite (llojit ultrabazike me plagjioklaz).

Keto lloje shkembore kane siperfaqe te konsiderueshme duke mbuluar te gjithë siperfaqen e kerkuar per leje minerare , duke mbetur te hapura ne skajin VL dhe JP dhe meridional. Kane ngjyre gri ne te errte ne jeshile ne te zbardhur ne varsi te permbajtjes se plagjiklazit. Shtrirja e pergjithshme eshte VP-JL me renie 65 -75 - 80° per ne JL.

Perfaqesohen nga llojet te ndryshme, duke filluar nga ato melanokrate, leukokrate mezokrate ku hera heres kalojne ne gabro -traktolite. Ne pergjithesi keto lloje shkembore jane pjeserisht te ndryshuara nga proceset dytesore si serpentinizimi, kloritizimi dhe kaolinitizimi.

Nga kryerja e disa punimeve te lehta siperfaqesore (karrjera, puseza, pastrime), rrezulton se masa shkembore e traktoliteve del direkt ne siperfaqe me nje kore alternimi 0.5 deri 3 cm, me nje mbulesë te vogel te mases shkembore nga deluvione 0.20- 0.40 ml dhe pjeserisht te zbuluara per siperfaqen e marre ne studim. Jasht kontureve te shfrytezimit ne krahun JL takohet mbulesë me trashesi 0.60ml deri 1.2ml, traktolite te kaolinizuara.

Çarshmeria ne pergjithesi eshte e zhvilluar dhe nuk ka orientim te caktuar. Ne masen shkembore verhen sektor me çarshmeri te vogel. Sektore me mbulesë te pakte dhe shkalle erodimi te vogel (pakaolinizuar) . Sektore ku prodhohen traktolitet melano- mezokrate, preferenca e te cilave eshte me e madhe per dekoracion ne ndertime.

Nga pikepamja stukturore kemi te bejme me krah monoklinali me shtrirje VL-JP me renie JL me kend 65 –85°.

Formacioni ofioliti qe nderton objektin perfaqeson nje kat strukturor me perberje te larmishme te shkemborëve intruziv te cilet kane lidhje te ngushte paragjenetike dhe i perkasin nje cikli tektoniko –magmatik.

- Rajoni perben nje stukture te gjere te rrudhosur antiklinale –izometrike dhe e inklinuar, gadi e permbysur me nderlikime tektonike.

Tektogjeneza e fuqishme ne kete rajon ka kushtezuar ngritjen ose uljen e formacioneve ofiolitike ne krahët e antiklinalit, nxjerrjen dhe mbyhypjen e luspave e blloqeve tektonike e patjeter obduksionin e pjeseshem te ofioliteve.



Te dhena te shkurtera per llojin e mineralit (shkembit)

Formacionet qe do ti nenshtrohen shfrytezimit jane shtrese trashe deri masiv . Shtresat bien ne drejtim te JL me kend 75° , pra ne te kundert me zhvillimin e punimeve te shfrytezimit. Objekti eshte tersisht i zhveshur , ralle gjen nje mbulese argjilore, humus mes gureve qe nuk arrijne me shume se 1% te mases shkembore.

Aktualisht mund te terhiqen nga ky sektor me mijera m^3 matrial ne formen e blloqeve me dimensione 30x60x80 cm deri 1x1.5x1m ne gjendje te gateshme. Keto lloje shkembore kane nje dekoracion mjaft te mire dhe jane te qendrueshem ndaj agjenteve atmosferik, luçidohen mire dhe jane shume te forte ne thyerje.

Ndertuesit kete tip te “ **mermereve** “ e fusin ne familjen e graniteve, jo vetem per shkak te fortesise dhe vetive dekorative, por edhe per faktin se keta shkembinj jane me prejardhje magmatike te thellesive.

Per kete objekt jane marre kampione per studimin mineralogjik dhe perberjen lendore.

-Treguesit cilesor te mineralit.

Perberja minerale sasiore e traktoliteve.

- Olivine 50%
- Piroksen monoklin 10 %
- Plagjioklaz 20%
- Kromite 1%
- Serpentine 16%
- Klorite 1%

- Magnetit dytesor 2%

Nga studimi i kryer rrezulton se mineralet jane shume pak te kataklazuar dhe te ndryshuar e cila rrite qendrshmerine e shkembtit dhe luçidueshmerine dhe perdorimin e tij.



Pamje e sipërfaqes se shfrytezimit

Perberja lendore (analiza e plote kimike) e shkembinjve kryesor te objektit te licensuar

Nr	Lloji I shkembtit	SiO ₂	TiO ₂	Al ₂ O ₃	Fe ₂ O ₃	FeO	MnO	MgO	CaO	Na ₂ O	K ₂ O	H ₂ O +	Hkv	P ₂ O ₅	V ₂ O ₅	N ₂ S
1	Gabro melano.	43.83	7.68	10.80	5.55	12.13	0.23	5.63	8.90	2.62	0.21	1.07	0.31	0.06	0.30	-
2	Gabro mezokrate	35.86	5.30	12.17	7.0	10.34	0.25	0.67	14.00	2.2	0.00	1.35	0.74	4.32	0.20	-
3	Traktolite	41.50	0.40	1.00	7.82	10.76	0.26	26.57	3.73	0.61	0.06	4.95	1.21	-	-	0.19
4	Verlite Plagjioklazi	51.78	0.55	2.23	1.08	14.14	0.30	25.16	3.15	0.44	0.00	0.79	0.00	-	0.20	-
5	Ultrabazik me magnetit	39.46	0.13	3.97	6.00	14.50	0.26	26.04	2.94	0.60	0.10	3.22	0.60	-	-	0.015
6	Gabro sideronite	41.78	6.55	12.27	5.62	11.50	0.22	6.66	9.81	2.25	0.25	1.53	0.06	0.007	0.3	-

Treguesit cilesor ne tabelen e mesiperme plotesojne me se miri kerkesat e tregut per perdorim ne ndertim dhe eksport te ketij minerali.

Me poshte po japim disa karakteristika gjeologo – inxhinierike dhe vetit fizikeo – mekanike te gureve dekorativ (traktolite) ne sheshin e kerkuar per shfrytezim ne gjendje natyrale.

Vetit fiziko - mekanike te xeherorit dhe te shkembinjëve rrethues (traktolite).

Struktura .

Struktura e gureve dekorativ (traktoliteve) eshte mezokokrrizore, rralle mikrokokerrizore, rralle gjen strukture brekçioze (afer zonave tektonike). Tektonika e shkembit eshte masive me shperndarje homogjene te komponentit te dobishem, rralle gjen teksture brekçioze, brezore shliroze.

Çarshmeria

Çarshmeria ne pergjithesi eshte e zhvilluar dhe nuk ka ndonje orientim te caktuar, por duhet theksuar se jo ne te gjitha rastet çarshmeria ka nje zhvillim uniforme, keshtu kemi sektor me çarshemri me te zhvilluar si dhe sektor më me pak çarshmeri.

Nisur nga vrojtimet ne terren dallohen :

- Sektori me çarshmeri me te vogel ne pjesen qendrore te objektit.
- Sektore me çarshemri te dukshme afer zonave tektonike.

Masa shkembore e ketyre shkembinjëve eshte me çarje ne pjesen e siperme dhe drejt thellesise kemi ulje te çarshemrise.

Ne siperfaqe keto lloje shkembore jane te eroduara deri 2-3cm.

Mikroçarshmeria dhe makroçarshmeria ka rendesi per shfrytezimin e trupit mineral, sepse ndan trupin ne pjese dhe blloqe me permasa te ndryshme, duke lehtesuar shfrytezimin.

Rrezistenca e shkembit

Sjellja mekanike e shkembinjëve traktolit ne pergjithesi eshte elastike. Vetit fiziko –mekanike varen nga dendsia e çarjeve dhe shkalla e serpentinitizimit dhe e proçeseve te mevoneshme.

Ne pergjithesi kane thyerje guackore copetohen sipas drejtimit te deshirushem.

Disa tregues te vetive fiziko- mekanike te shkembinjëve traktolite per sheshin e studiuar jane:

- masa specifike 2.4 – 2.85 gr / cm³
- masa vellimore 2.2 – 2.7 gr /cm³
- poroziteti - 3- 10 %
- koficenti i filtrimit < 10⁻⁷ m/sek
- ujetithja specifike 0.05 - 0.005 l/min/ml
- rezistenca ne shtypje njoboshtore 300 – 1400 bar
- rezistenca ne prerje 50 –250 bar
- moduli i elasticitetit 10³ - 10⁵

Rrezistenca e shkëmbinjëve ndikon tek punimet e hapjes dhe pregaditore, para se të shkojë në trup mineral.

Fortesia e shkëmbinjëve për (traktolitet) është me kategori VII dhe VIII, ndërsa për gabrot kategori VIII^{te}.

Studimi i parametërve fizik

Ky studim është bërë si në vrojtimit në terren ashtu edhe në studimet laboratorike.

Ngjyra

Gjate studimit në terren u vrojtua ngjyra e traktoliteve e cila luahet nga gri e erret deri në të zeze me kristale të zgjatur plajiklazit, ku mbizoteron sfondi i zi me nuanca të bardha për traktolitet melanokrate dhe gri në të bardhë për traktolitet mezokrate të cilat i japin pllakave një dizenjo shumë të pelqeshme.

Vetit dekorative

Në pllakat e bera në ish Ndeermarrjen artistike “Migjeni” Shkoder për traktolitet bie në sy ngjyra gri e mbyllur deri në të zeze me damare të zgjatur të plajiklazit të bardhë duke rritur shumë vlerën dekorative. Në disa raste kemi zotërim të ngjyres bardhë dhe zi në rastin e traktoliteve mezokrate.

Fortesia

U studiua fortësia e traktoliteve dhe tingëllimi gjatë goditjes me çekiç që shpreh një veti mjaft të përdorur në guret dekorativ të ngjashëm me tingëllimin metalik, që tregon për fortësinë e tyre, duke plotësuar kërkesat e tregut

Për të gjykuar dhe përcaktuar drejt mënyrën e shfrytëzimit të objektit u krye, për çdo shkallë, llogaritja e rezervave, volumi i zbulimit dhe koeficienti mesatar i zbulimit. Rezultatet e llogaritjeve janë paraqitur në tabelën e mëposhteme.

Duke marrë në konsideratë elemente të tjera si: topografine, sasinë e rezervave, karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjëve, elementet e shtruarjes dhe koeficientin paraprak të zbulimit për heqjen e dherave dhe shkëmbinjëve të ciptuar në sipërfaqe sipas shkallëve 2.71-3.35 - 3.7m³ masiv/m³ masiv, është parashikuar shfrytëzimi me kariere të rezervave të llogaritura të objektit me kouta të poshtëm +1310 m dhe kuota të sipërme +1350m

Në tabelën e mëposhteme janë dhënë llogaritjet e vëllimit të rezervave të nxjerrshme duke marrë në konsideratë raportin e zbulimit ose humbjet gjatë shfrytëzimit

Treguesit e pritshëm në natyrë për shfrytëzimin e traktoliteve

Nr	Shkalla	Vol. m ³	K Shfrytëzimit%	Humbje nga shfrytëzimi, m ³	Rezerva të nxjerrshme, m ³
1	1350	43500	0.21	9135	34365
2	1340	485350	0.21	101923.5	383 426
3	1330	1171600	0.21	246036	925 564
4	1320	1713250	0.21	359782.5	1 353 468
5	1310	1973750	0.21	414487.5	1 559 263
	Karriera	5387450		1131364.5	4 256 086

Kryerja e punimeve të shfrytëzimit me qiell të hapur, gjithashtu, favorizohet nga:

- ✚ Renia e formacioneve, që ndërtohen pakon produktive në drejtim të kundret me terrenin, në pjesën perëndimore dhe të njëjta me atë lindore në të cilat parashikohet të zhvillohet aktiviteti mineral.
- ✚ Forma e pershtatshme e traktoliteve, shtresa me permasa të ndryshme e me prezencën e rafsheve të çarshmerise, të cilat mund të levizën me lehtësi me dorë ose me mjete të mekanizuara pa patur nevojën e përdorimit të Lendeve Plasese. Menyra e shkeputjes së blloqeve të traktolitit do të trajtohet në kapitujt me poshtë ;
- ✚ Thellesia relativisht e vogël e germimit (deri në 20 m), e cila mundeson ruajtjen të një kendi të pjerësise së terrenit të pershtatshëm për rehabilitimin pas shfrytëzimit ;
- ✚ Hidrogarfia e zonës në përgjithësi dhe e pjesës së kerkuar për leje minerare në veçanti, e cila nuk krijon probleme për shfrytëzimin e vendburimit.
- ✚ Perroskat që përshkojnë zonën e kerkuar nuk kanë ndonjë ndikim të konsiderueshëm në mënyrën e shfrytëzimit dhe në ecurinë e saj mbasi nuk kanë prurje të vazhdueshme uji
- ✚ Hidrologjia , burimet e ujërave etj, të cilat nuk janë të pranishme në zonën e shfrytëzimit.
- ✚ Koeficienti i zbulimit, në saj të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe shtesë për depozitimin e përhershëm ose të përkohshëm të sterileve

Menyra e hapjes

Relievi i sipërfaqes. ku ndodhë objekti, ka kushte të pershtatshme që favorizojnë hapjen me transe me gjysëm seksioni me një kalim, gjerësia e saj do të jetë në funksion të mënyrës të transportit të blloqeve të gelqeroreve dhe sterilit, paraprakisht është pranuar 4 m.

Për hapjen e objektit parashikohet të hapen dy segmente rruge që do të lidhin përkatesisht kuotën e shkallës +1350 dhe atë të shkallës +1320..

